

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Nr. *137/* Prot.

Tiranë, më 17. 07. 2017

Lënda: Thirrje për Aplikime- **Projekte Dypalëshe të Bashkëpunimit Tekniko-Shkencor Shqipëri - Itali.**

Në kuadër të Marrëveshjes e Programit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit e Sportit (MAS) të Republikës së Shqipërisë dhe Qendrës Kombëtare të Kërkimeve – (Centro Nazionale të Ricerca- CNR), nënshkruar më datë 19.05.2017, ju bëjmë me dije se Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si agjenci ekzekutive e ngarkuar për zbatimin e kësaj marrëveshje, fton stafin akademik të institucioneve publike e jo-publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin projekt-propozimet e tyre.

Sjellim në vëmendjen tuaj se **Projektet Dypalëshe të Bashkëpunimit Tekniko-Shkencor, Shqipëri - Itali**, janë projekte që synojnë kryesisht mobilitetin akademik dhe mbështen nga grante të vogla, maksimumi për një kohëzgjatje 2 – vjeçare, me nje shumë prej 2 500 EURO, në vit.

Për këtë arsye, ju ftojmë ta shpërndani këtë informacion në stafin e institucionit tuaj, në mënyrë që të interesuarit të shprehin interesin për të aplikuar.

Aktivitetet e projektit synojnë kryesisht nxitjen e bashkëpunimit mes studiuesve shqiptarë dhe atyre italianë, përmes mobilitetit akademik, duke patur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe mundësinë e realizimit të partneriteteve, për projekte afatgjata në kuadër të ERASMUS+, apo HORIZON 2020.

Projektet e paraqitura duhet të dorëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit (AKKSHI) **brenda datës 29 shtator, 2017 (12:00, ora lokale)**, në adresën e mëposhtme:

Të gjithë materialet për aplikimin mund ti gjeni në linkun e mëposhtëm:

http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/bursa/2017/Thirrje_per_Aplikim_MAS_CNR.pdf

Për çdo paqartësi e informacion, mund të kontaktoni me Evis Tasellari në:

evis.tasellari@akti.gov.al

GERON KAMBERI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM